



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr.doc. 202300106/6

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda :** Rekomandim për monitorimin e vazhdueshëm dhe efektiv të mjediseve të institucioneve arsimore me qëllim parandalimin e reklamimit dhe konsumimit të ushqimeve të dëmshme për shëndetin.

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), në ushtrim të mandatit të tij kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, ka si një ndër prioritetet e punës së tij edhe mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijës. Bazuar në informacionin e transmetuar në median *online* “Dosja.al<sup>1</sup>”, jemi vënë në dijeni të lajmit të helmimit të disa nxënësve në një shkollë në fshatin Memzotaj, Kavajë ku, fëmijët/nxënësit kishin shfaqur probleme shëndetësore pasi kishin konsumuar disa produkte ushqimore. Në përputhje me nenin 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar (ligji nr.8454/1999), AP-ja filloi shqyrtimin me iniciativë të këtij rasti, që lidhet me garantimin e një zhvillimi të shëndetshëm fizik të fëmijëve

<sup>1</sup> <https://dosja.al/aktualitet/blene-ushqime-te-dyqani-afere-shkolles-nxenesit-shfaqin-probleme-shend-i274303>

dhe, më kryesorja në mbrojtjen e jetës së tyre. Garantimi i mirëqenies dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik është mjaft i rëndësishëm<sup>2</sup>.

Pasi është njohur me rastin, institucioni i AP-së ka kryer një sërë veprimesh në kuadër të hetimit administrativ, duke kërkuar informacion dhe shpjegime pranë disa strukturave shtetërore në nivel vendor.

Konkretisht, me tonën nr. K1/I7-2 datë 08.02.2023 kemi kërkuar shpjegime nga Zyra Vendore Arsimore (ZVA) Kavajë, si dhe nga Komisariati i Policisë Kavajë nëpërmjet shkresës me nr. K5/I7-4 datë 23.03.2023, nëse kanë pasur dijeni për rastin në fjalë dhe, cilat janë masat që janë marrë për trajtimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në interesin më të lartë të fëmijëve, për garantimin e shëndetit të tyre.

ZVA-ja<sup>3</sup> dhe Komisariati i Policisë Kavajë<sup>4</sup>, na kanë bërë me dije ndër të tjera se “*... gjatë orës së pushimit të datës 23.01.2023, nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Memzotaj, konsumuan produkte në një dyqan në afërsi shkollës. Pas konsumimit të ushqimit, nxënësit filluan të mos ndihen mirë, duke pasur disa shqetësime, si të përziera stomaku. Pasi nxënësit njoftuan mësuesin kujdestar dhe drejtorin e shkollës në moment u njoftuan edhe prindërit e nxënësve dhe u bë dërgimi i tyre në spital për të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore. Psikologu i shkollës ka njoftuar organet e policisë së shtetit dhe së bashku me Agjensinë Kombëtare të Ushqimit, kryen procedurat e nevojshme për rastin në fjalë. AKU ka konstatuar produkte të skaduar dhe nga ku dyshohet se janë helmuar pesë nxënës të mitur të shkollës 9-vjeçare të fshatit Memzotaj, Njësia Administrative Helmas, Kavajë. Konkretisht, nxënësit ishin, V.B. 13 vjeç, M.B. 11 vjeç. S.I. 11 vjeç, S.B. 11 vjeç dhe S.H. 14 vjeç. Komisariati i Policisë Kavajë, menjëherë ka ngritur grupin hetimor për hetimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale për dokumentimin ligjor. Në përfundim të veprimeve të para hetimore është proceduar penalisht në gjendje të lirë pronari i këtij biznesi minimarket me iniciale M.H. banues në Memzotaj, Kavajë, janë bllokuar produktet ushqimore nga AKU si dhe janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme. Materialet procedurale janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë për vepren penale “Prodhim dhe shitja e ushqimeve dhe e*

---

<sup>2</sup> Gërma “c”, e nenit 2, të ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

<sup>3</sup> Shkresa me nr.193/1 prot.datë 13.03.2023 e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë.

<sup>4</sup> Shkresa me nr.1351/1 prot.datë 07.04.2023 e Komisarariatit të Policisë Kavajë.

*lëndeve të tjera të rrezikshme për shëndetin”, e parashikuar nga neni 288 i K.Penal, dhe aktualisht dasja penale është nën hetim.*

Mirëushqyerja është një nga faktorët kryesorë që ndikon në shëndetin e një individi, sidomos gjatë moshës shkollë, me qëllim që fëmija të rritet e të zhvillohet, të ketë shëndet sa më të mirë dhe jetëgjatësi. Ndaj është e rëndësishme që stafet psiko-sociale në shkollë, me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore<sup>5</sup>, në bashkëpunim me familjen dhe stafin mësimor, të kontribuojnë në edukimin dhe promovimin e ushqyerjes së shëndetshme<sup>6</sup> për fëmijët. Është e rëndësishme që nxënësit, sidomos ata të arsimit parauniversitar të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme, të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë në tërësi, si dhe të përballen në mënyrë të përshtatshme dhe konstruktive me sfidat e jetës dhe mjedisit global.

Perioda e frekuentimit të shkollës luan një rol parësor në formimin e personalitetit të fëmijëve, nëpërmjet edukimit dhe formimit të tyre, si individë të lirë, të përgjegjshëm e të angazhuar në shoqëri. Jo vetëm prindërit, por edhe institucionet e organizatat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut kërkojnë që institucionet edukuese e, sidomos ato bazë e të detyrueshme, të ofrojnë mbi të gjitha një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për fëmijët. Kjo është një çështje me rëndësi, pasi niveli i sotëm i zhvillimit fizik dhe mendor të fëmijëve është përcaktues për të ardhmen e vendit.

Neni 59, pika 1, germa “ç”, e Kushtetutës së RSH-së, përcakton se, shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm për të gjithë individët. Gjithashtu, mbështetur në nenin 21, pika 2, gërmat “c” dhe “d”, të ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) garanton të drejtën për kujdes shëndetësor dhe merr masa për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror. Kjo ministri (MSHMS), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) kujdeset, që të gjitha grupet shoqërore dhe, në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të

---

<sup>5</sup> Siguria ushqimore i referohet të gjitha atyre rreziqeve të cilat mund ti shkaktojnë dëme ushqimit dhe kështu shëndetit të konsumatorit.

<sup>6</sup>Ushqyerja konsiderohet e shëndetshme kur sasia dhe llojshmëria e ushqimeve të marra janë të përshtatshme për të plotësuar nevojat e organizmit me të gjithë lëndët ushqyese në sasi të nevojshme për funksionimin normal, rritjen dhe mirëmbajtjen e organizmit.

ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe përmirësimin e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve.

Nenet 3, 21 dhe 22, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, parashikojnë se arsimit parashkollor dhe ai bazë synojnë ndër të tjera zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor, zotërimin e rregullave të sjelljes, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës.

MAS-i, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike<sup>7</sup>.

Të ushqyerit është një ndër nevojat më të rëndësishme në jetën tonë. Me kalimin e viteve, nevojat tona për ushqim ndryshojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të shëndetit dhe rrjedhimisht, në cilësinë e jetesës. Respektimi i një **diete ushqimore** cilësore është shumë i rëndësishëm për shëndetin dhe mirëqenien e njeriut duke reduktuar rrezikun e disa sëmundjeve. Kjo, sepse ushqimi na furnizon me energji dhe vlera ushqyese që janë thelbësore për funksionimin e trupit tonë.

Përveçse në zhvillimin fizik, ushqimi ndikon edhe në zhvillimin e trurit të njeriut. Truri është përgjegjës për mendimet dhe lëvizjet, frymëmarrjen dhe rrahjet e zemrës, shqisat, madje punon edhe kur njeriu është në gjumë. Kjo do të thotë se truri kërkon furnizim të vazhdueshëm me energji. Energjia vjen nga ushqimet që hamë dhe çfarë është në përbërjen e tyre. E thënë thjesht, ajo që hamë ndikon drejtpërdrejt në strukturën dhe funksionin e trurit tonë dhe, në fund të fundit, në humorin tonë.

Ngrënia e ushqimeve me cilësi të lartë që përmbajnë shumë vitamina, minerale dhe antioksidantë ushqen trurin dhe e mbron atë nga stresi oksidativ – “mbeturinat” (radikalet e lira) të prodhuara kur trupi përdor oksigjenin - i cili mund të dëmtojë qelizat. Studime të shumta kanë gjetur një lidhje midis një diete të lartë në sheqerna të rafinuar dhe funksionit të dobët të trurit – madje edhe një përkeqësim të simptomave të çrregullimeve të humorit, siç është depresioni<sup>8</sup>.

---

<sup>7</sup> Shkronja “dh”, e nenit 18, të ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

<sup>8</sup> <https://www.health.harvard.edu/blog/nutritional-psychiatry-your-brain-on-food-201511168626>

Ushqyerja është veçanërisht e rëndësishme gjatë fëmijërisë, e cila është periudhë vendimtare për formimin e trurit, kur hidhen themelet për zhvillimin e aftësive njohëse, motorike dhe socio-emocionale gjatë gjithë fëmijërisë dhe moshës madhore. Ushqimi dhe ushqyerja, thelbësore në ruajtjen e performancës së trurit, gjithashtu ndihmon në parandalimin dhe trajtimin e çrregullimeve mendore. Si përbërja e përgjithshme e dietës njerëzore, ashtu edhe përbërësit e veçantë të dietës kanë një rol në disa fusha kyçe të funksionit të trurit që lidhen me shëndetin mendor dhe performancën, duke përfshirë: (1) zhvillimin e trurit, (2) rrjetet e sinjalizimit dhe neurotransmetuesit në tru, (3) aftësitë konjitive dhe kujtesën, (4) ekuilibrin midis formimit dhe degradimit të proteinave etj<sup>9</sup>.

Referuar **sindromës së mungesës së përqëndrimit**<sup>10</sup>, prindërit, kujdestarët etj., kanë vënë re se pas sjelljeve problematike dhe performancës së dobët në mësimet fshihen mangësi ushqimore apo zgjedhje të gabuara. Sindroma e mungesës së përqëndrimit të fëmijët mund të vijë nga prishja e ekuilibrit të neurotransmetuesve<sup>11</sup>. Fëmijët me këtë sindromë, përdorin sjellje të padëshirueshme dhe hiperaktivitet mendor për të stimuluar prodhimin e këtyre lëndëve kimike të trurit. Por, kjo pasohet me stres dhe me zbrastje të neurotransmetuesve dhe fëmijët dalin jashtë kontrollit duke pasqyruar atë që quhet bllokimi i trurit<sup>12</sup>.

Pra, tingëllon shumë logjike që një fëmijë me tendencë për sindromën e mangësisë së përqëndrimit të përfitojë shumë nga një dietë e cila e ushqen mjaftueshëm për të prodhuar këto lëndë kimike. Acidet yyrore omega-3 përbëjnë element kyç të dietës. Këto yndyrna dhe nutrientë të tjerë që nuk prodhohen dot nga organizmi duhen siguruar nga ushqimi.

Në periudhën e **fëmijërisë, 0-10 vjeç**, trupi rritet shpejt dhe të ushqyerit tek fëmijët duhet të bëhet sipas një mase të caktuar. Prindërit, kujdestarët etj., nuk duhet të bazohen tek reklama që ju bëhet ushqimeve, por tek cilësia e tyre. Po kështu gjatë periudhës së **adoleshencës, 10 deri 20 vjeç**, hormonet nxitin urinë dhe kjo është periudha më vendimtare që formëson mënyrën e të ushqyerit për gjithë jetën. Kështu,

---

<sup>9</sup> <https://academic.oup.com/nutritionreviews/article/79/6/693/5912697>

<sup>10</sup><https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/ushqimi-i-shendetshem-nderton-tru-te-shendetshem>

<sup>11</sup>Neuro-përcjellësit si: serotonina, dopamina dhe adrenalina transmetojnë mesazhe nga një qelizë në tjetrën dhe ndikojnë në gjendjen tonë shpirtërore si dhe në mendimet dhe veprimet tona.

<sup>12</sup>“Blokues të trurit”: Alkooli, ushqimet artificiale, ngjyruet, ëmbëlsues artificialë, pijet me gaz të tipit cola, kremrat e pastërisë, pije me sheqer, yndyra të hidrogjenizuara (si margarina), nikotina, tejnigopja, buka e bardhë.

nevojitet vëmendje edhe më e shtuar nga prindërit dhe institucionet arsimore për të siguruar bazat për një shëndet të mirë.

Duke u rritur, ekspozimi i fëmijëve ndaj ushqimeve të pashëndetshme është fenomen i shpeshtë dhe orientohet ndjeshëm nga marketimi dhe reklamimi i papërshtatshëm, niveli i lartë i ushqimeve shumë të përpunuara si dhe rritja e aksesit ndaj fast food-it dhe pijeve me sheqer të shtuar. Kjo ndodh jo vetëm në qytete, por edhe në zonat rurale.

Për shembull, sipas raportit të UNICEF<sup>13</sup>, 42% e adoleshentëve që ndjekin shkollën në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme konsumojnë pije freskuese me gaz dhe sheqer të shtuar të paktën një herë në ditë, dhe të paktën 46% hanë fast food të paktën një herë në javë. Këto përqindje rriten përkatësisht në 62% dhe 49% tek adoleshentët në vendet me të ardhura të larta. Sipas raportit, barra më e madhe e kequshqyerjes në të gjitha format e saj përballohet nga fëmijët dhe adoleshentët në komunitetet më të varfra dhe të marginalizuara<sup>14</sup>.

Si rrjedhojë, nivelet e mbipeshës dhe obezitetit në fëmijëri dhe adoleshencë po rriten në mbarë botën. Gjatë periudhës 2000-2016, raporti i fëmijëve mbipeshë midis moshë 5-19 vjeç u dyfishua nga 1 në 10, në thuajse 1 në 5. Në krahasim me vitin 1975, sot vuajnë nga obeziteti dhjetë herë më shumë vajza dhe 12 herë më shumë djem. Sipas një studimi të vitit 2018 nga FAO (Food Agriculture Organization) dhe Instituti i Shëndetit Publik, në Shqipëri 17% e fëmijëve në moshë shkollore janë mbipeshë.

Prandaj, prindërit dhe institucionet arsimore duhet t'i mësojnë fëmijët për ushqyerjen e shëndetshme, që në moshë të vogël dhe t'i ndihmojnë fëmijët të kenë një marrëdhënie positive me ushqimin. Kjo arrihet duke ju mësuar atyre zakone të mira të ushqyerjes së shëndetshme, duke i informuar për sigurinë ushqimore dhe sëmundjet, si dhe promovuar zgjedhje ushqimore të përgjegjshme dhe të shëndetshme.

Në përfundim, ky rekomandim vlerëson pozitivisht miratimin e urdhrin të përbashkët nr.355, datë 14.07.2021 të ministrit të MSHMS-së dhe ministrit të MAS-it “Për miratimin e rregullores “për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë”. Kjo rregullore ka për qëllim ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve

<sup>13</sup>Raport UNICEF: [Gjendja e Fëmijëve në Botë 2019: Fëmijët, ushqimi dhe ushqyerja.](https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/unicef-paralajm%C3%ABron-m%C3%ABnyrat-e-pap%C3%ABrshtatshme-t%C3%AB-ushqyrjes-e-d%C3%ABmtojn%C3%AB-sh%C3%ABndetin-e)

<sup>14</sup> <https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/unicef-paralajm%C3%ABron-m%C3%ABnyrat-e-pap%C3%ABrshtatshme-t%C3%AB-ushqyrjes-e-d%C3%ABmtojn%C3%AB-sh%C3%ABndetin-e>

arsimore të arsimit bazë dhe përcaktimin e rregullave të ndalimit të këtij lloji në kuadër të luftës kundër kequshqyerjes. Gjithashtu, rregullorja synon të realizojë mbrojtjen e shëndetit e të mirëqenies së fëmijëve nga informacione e materiale që i dëmtojnë ato<sup>15</sup> si dhe nga ushqimet e pashëndetshme<sup>16</sup>. Ndërkohë përsëritja e ngjarjeve si ajo që sollëm në këtë rekomandim, tregon se zbatimi i rregullores ka nevojë të përmirësohet dhe njohja e saj të jetë përmbajtësore.

Për këtë qëllim, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre, në zbatim të legjislacionit dhe të instrumenteve ndërkombëtare, bazuar edhe në Deklaratën e Meridës “Mbi rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”, si dhe rolit specifik në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, institucioni i AP-së është një nga aktorët e angazhuar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të këtyre objektivave. Konkretisht, objektivi 2, pohon rëndësinë e garantimit të një sigurie ushqimore dhe përmirësimit të të ushqyerit ku, autoritetet shtetërore deri në vitin 2030, t’i kenë dhënë fund të gjitha formave të kequshqyerjes.

Në këtë kuptim, AP-ja, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999,

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave, të menjëhershme për monitorimin e vazhdueshëm dhe efektiv të mjediseve të institucioneve arsimore me qëllim parandalimin e reklamimit dhe konsumimit të ushqimeve të pashëndetshme.
- Marrjen e masave për dhënien e informacionit në shkolla lidhur me sigurinë ushqimore dhe promovimin e zgjedhjeve të shëndetshme ushqimore.

---

<sup>15</sup> Pika 1 e nenit 1 të urdhërit nr.335, datë 14.07.2021 “Për miratimin e rregullores “për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë”.

<sup>16</sup> Konsiderohen ushqime të pashëndetshme ato me përmbajtje të lartë yndyre, acidi yndyror, kripe, natriumi e sheqeri që janë tej normave të lejuara.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për miëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

**Me respekt**

**K O M I S I O N E R**

**OLTA ALIAJ**